



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2021:258071  
Datë: 04.02.2022  
Numri i dokumentit: 02680083

Pml.nr.10/2022

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj-kryetare, Nesrin Lushta e Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit E.R., nga fshati D., komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit D.Q., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.940/2021 të datës 25.11.2021, në seancën e mbajtur më datë 18.01.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e përfaqësuesit të dëmtuarit D.Q., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.940/2021 të datës 25.11.2021.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.940/2021 të datës 25.11.2021, është refuzuar si i pabazuar kundërshtimi i mbrojtësit të dëmtuarit D.Q. kundër urdhrorit të gjyqtarit të procedurës paraprake PN.nr.308/2020 të datës 05.11.2021 për caktimin e masës së përkohshme për sigurimin e pasurisë.

Kundër këtij aktvendimi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur përfaqësuesi i të dëmtuarit, avokati Valdrin Behrami nga Prishtina, duke mos e cekur bazën ligjore, me të cilën propozon që aktvendimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.8/2022 e datës 11.01.2022, ka propozuar që kërkesa të hedhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi afatshmërinë dhe lejueshmërisë e kërkesë, në kuptim të nenit 435 par.1 të KPPK dhe konstatoi se:

- kërkesa është e papranueshme.

Konform dispozitës së nenit 433 par.1 të KPPK kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424 par.1 fjalia e fundit të këtij Kodi.

Andaj, nga kjo dispozitë ligjore del se i dëmtuari nuk është në mesin e personave me të drejt të paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa ishte e papranueshme.

Përveç kësaj, konform nenit 432 par.1 të KPPK kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me situatë të këtillë sepse procedura penale nuk ka përfunduar në formë të prerë por kërkesa është paraqitur kundër aktvendimit për refuzimin e kundërshtimit të përfaqësuesit të dëmtuarit kundër një urdhri të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Për arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hodh si e papranueshme në kuptim të nenit 435. par.2. të KPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.10/2022, më datë 18.01.2022

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Mejreme Memaj